



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 2

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 12 janar 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 9.1.2018	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare..... 27
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 9.1.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në shërbimin spitalor”, të ndryshuar..... 27
Urdhër i drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 7, datë 5.1.2018	Për delegim të kompetencave..... 28
Urdhër i Kryetarit të Gjykatës së Lartë nr. 4, datë 3.1.2018	Për delegim kompetencash..... 29
Autorizim i Kryetarit të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 3.1.2018	Për delegimin e detyrave të nëpunësit autorizues (NA)..... 29
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 3, datë 5.1.2018	Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Gledjon Rehovica, me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”..... 29
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 4, datë 5.1.2018	Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Aqif Rakipi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”..... 30



VENDIM
Nr. 4, datë 9.1.2018

PËR NJË SHITESË FONDI
NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR
PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE
QEVERITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, zëri “Shërbime qeveritare”, t’i shtohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh, për organizimin e eventeve, në kuadër të “Vitet Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut”.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 5, datë 9.1.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 308, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN
E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE QË DO TË
FINANCOHEN NGA FONDI
I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
NË SHËRBIMIN SPITALOR”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shtojcat 6 dhe 7 që i bashkëlidhen vendimit nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohen përkatësisht me shtojcat me të njëjtin numër që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Shtojca 6

	Kostoja 2017	Njësia	Marzhi i fitimit	Çmimi i paketës
Paketa e trajtimit të kataraktës	20,157	lekë për paketë	8%	21,770
Në këtë paketë përfshihen:				
Kryerja e interventit				



Paketa e shërbimeve të radioterapisë (me akselerator linear)	Kostoja 2017	Njësia	Marzhi i fitimit	Çmimi i paketës
Paketa e trajtimit paliativ (1–10 seanca trajtimi)	7,068	lekë për seancë	5%	7,421
Në këtë paketë përfshihen: ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe seancat me akselerator linear.				
6537 Paketa e trajtimit adjuvant/ neoadjuvant (15–33 seanca trajtimi)	5,780	lekë për seancë	5%	6,069
Në këtë paketë përfshihen ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear.				
Paketa e trajtimit radikal (15–35 seanca trajtimi)	6,031	lekë për seancë	5%	6,333
Në këtë paketë përfshihen ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear.				
Paketa e trajtimit me IMRT (15–39 seanca trajtimi)	6,053	lekë për seancë	5%	6,356
Në këtë paketë përfshihen ekzaminimet dhe konsultat e nevojshme, si dhe trajtimi me akselerator linear (IMRT)				

URDHËR
Nr. 7, datë 5.1.2018

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004, “Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, neni 26 i rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)”, të ndryshuar me urdhrin nr. 150, datë 26.9.2017,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave që lidhen me procedurat e verifikimit të sigurisë së individëve që aplikojnë për CSP-në dhe operatorëve ekonomikë që aplikojnë për CSI-në, z. Mark Ndreca, me detyrë, drejtor i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial.

2. Autorizoj z. Ndreca të kryejë veprimet si më poshtë:

a) Të firmosë shkresat drejtuar autoriteteve verifikuese për verifikimin e sigurisë.

b) Të firmosë shkresat me të dhënat e operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshëm drejtuar autoriteteve kontraktore.

c) Të firmosë shkresat për përditësimin e rekordeve të operatorëve ekonomikë të certifikuar përshtatshëm drejtuar autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

d) Të firmosë shkresat përcjellëse për dërgimin e CSP-së tek institucionet shtetërore.

3. Ky urdhër do të jetë në fuqi deri në datën 31.12.2018.

4. Z. Ndreca nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Mark Ndreca, drejtor i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial; dhe arkiv/protokoli i DSIK-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI
Dorian Tola

**URDHËR****Nr. 4, datë 3.1.2018****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të nenit 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e prokurimit në Gjykatën e Lartë, kancelarit, z. Rudin Baqli.

2. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri kancelari i Gjykatës së Lartë.

4. Ky urdhër hyn në fuqi në datën 1.1.2018 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Xhezair Zaganjori

AUTORIZIM**Nr. 3, datë 3.1.2018****PËR DELEGIMIN E DETYRAVE TË NËPUNËSIT AUTORIZUES (NA)**

Me këtë akt, kryetari i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, z. Xhezair Zaganjori, i cili me ligj është nëpunës autorizues i kësaj gjykate, i delegon të gjitha detyrat e lidhura me financën dhe buxhetin kancelarit të gjykatës, z. Rudin Baqli.

Me këtë marrëveshje, kancelari garanton se do të përmbushë të gjitha detyrat e nëpunësit autorizues me kujdesin e duhur.

Të dyja palët vendosin bashkërisht të krijojnë një sistem raportimi që garanton se kryetari është plotësisht i informuar për gjendjen buxhetore të gjykatës.

Ky akt i delegimit të përgjithshëm është:

- I vlefshëm deri në datën 31.12.2018.

Të dyja palët e kuptojnë, që delegimi i detyrave nuk mund të nënkuptojë kurrë delegimin e përgjegjësisë.

KRYETARI
Xhezair Zaganjori

VENDIM**Nr. 3, datë 5.1.2018**

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. GLEDJON REHOVICA, ME DETYRË DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 5.1.2018, me pjesëmarrjen e:

Klement	Zguri	kryetar
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Gledjon Rehovica, me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa “d”, i ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu III, pika 3, germa “ç”, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenin 10, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe kreu III, pika 3, germa “ç”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi



zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit z. Gledion Tomorr Rahovica.

2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryetarit të Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KRYETARI
Klement Zguri

VENDIM
Nr. 4, datë 5.1.2018

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. AQIF RAKIPI, DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 5.1.2018, me pjesëmarrjen e:

Klement	Zguri	kryetar
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Aqif Rakipi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi

Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa “d”, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu III, pika 3, germa “ç”, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; neni 10, pika 1, germa “d”, neni 14, neni 15, pika 3 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu III, pika 3, germa “ç”, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit z. Aqif Karaman Rakipi.

2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryetarit të Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KRYETARI
Klement Zguri

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 56 lekë